

Historia e kinematografisë shqiptare

Filmi në Shqipëri dhe Kosovë

Ajo që kishte ndodhur në Europë, Amerikë e gjetiu në arenën e kinematografisë, natyrisht ishte shumë e vonuar në Shqipëri. Nuk mund te flitej as për zbulime as për shfaqje të filmit në vitet e hershme të tij.

Megjithatë, në historinë e kinematografisë shqiptare, mund të përmendim fillimisht përpjekjet për fotografimin, të fotografit të njohur të kohës, Pjetër Marubi, i lindur në Piacenza –Itali më 1834, i cili nisi aktivitetin e vet prej fotografi shumë herët, qysh në vitin 1856, në Vilajetin e Shkodrës. Me “kutinë magjike”, më 1858, ai nisi të fotografojë jetën jashtë studios, ndër të cilat edhe ngjarjet politike të kohës, si për shembull “Kryengritja e Mirditës” (1876-77); Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-81), që mbetën dëshmi edhe në faqet e revistave të njohura evropiane “La guera d’Orient”, “The Illustrated London News”, “L’illustration”, etj.

Pionieri i shfaqjes së filmave në Shqipëri ishte Kolë Idromeno (1860-1939), piktor dhe arkitekt, i cili në vitin 1883 ngriti në Shkodër një laborator të quajtur “Dritëshkronja Idromeno” dhe në vitin 1908 fillon të organizojë shfaqjen e filmave të parë. Më vonë u hapën edhe klube në të cilat shfaqeshin shfaqje të tilla. I tillë ishte klubi “Gjuha shqipe” (1911) në Shkodër dhe “Kafe Stema” në Korçë.

Në vitin 1920 Kinema Përparimi u hap në qytetin bregdetar të Vlorës, dhe pas saj u hapën disa salla të tjera në Shkodër, Berat si dhe në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë. Kur fashistët Italianë pushtuan Shqipërinë, në vend kishte 18 salla kinemaje. Gjatë këtij pushtimi, pati shumë përpjekje për të ndërtuar një industri filmi. Përpara se Gjermanët të pushtonin Shqipërinë, një kineast i ri, Mihallaq Mone (1917-1984), xhiroi disa dokumentarë të shkurtër dhe madje u përpoq të prodhonte filmin e parë shqiptar, “Takim në liqen”. Në rol kryesor do të ishte ylli i kinemasë rumune, shqiptari Kristaq Antoniu.

Realizimet e para filmike në Shqipëri, ishin kronika. Kronika e parë është kronika e Kongresit të Manastirit (1908). Këtu edhe mund të hapim edhe fusnotat historike për vëllezërit Manaki për të cilët grekët thonë se janë me origjinë greke, maqedonët se i takojnë kombit maqedonas kurse ne mendojmë se ata janë manastiras, gjegjësisht shqiptarë. Nëse konstatohet kështu si mendojme ne, atëherë historia e xhirimeve nga xhirues shqiptarë është shumë më e pasur falë pikërisht vëllezërve Manaki nga Manastiri sepse ata konsiderohen pionierët e xhirimeve të imazheve filmike në Ballkan, posaçërisht të xhirimeve në vitet e para të lindjes së kinematografisë.

Pos tyre mund të përmendim edhe shoqatën italiane "Cines" e Torinos, e cila më 1909 xhirooi filmin "Shqipëria ngre krye" (Albania Ribele), film ky që tregon për luftimet e atdhetarëve shqiptarë kundër agresionit të fqinjve. Ky film, llogaritet si filmi më i vjetër me temë shqiptare i xhiruar nga të huajt.

Pastaj radhiten ekspedicione xhiruese nga Anglia, pastaj përfaqësues të firmës Gaumont nga Franca që xhirojnë copëtimin e tokave shqiptare dhe një film për Plavën dhe Gucinë.

Sidoqoftë filmi i parë i xhiruar nga një shqiptar, mendohet të ketë qenë një kronikë e filmuar për Shqipërinë nga konsulli shqiptar në Boston, i cili u shfaq më 1928 në një panair tregtar. Më 1937 një tjetër amator anonim xhirooi një kronikë në Korçë që zgjaste 8-9 minuta, dhe si duket kjo ishte e tëra për kohën e paraluftës.

Gjatë 30 vjetëve pas Shpalljes së Pavarësisë (1912) u xhiruan kryesisht kronika, filma dokumentarë, nga shoqëri të huaja kinematografike të Evropës apo SHBA, si dhe nga amatorë.

Agjencia Shqiptare e Filmave

Pas luftës së dytë botërore dhe pas çlirimit të Shqipërisë, shteti nxori dekretligj me të cilin kinematë private kalojnë në pronë shtetërore dhe që nga atëherë në to shfaqen filma të paktë të cilët arrijnë të kalojnë nëpër filtrat e rreptë të censurës partiake.

Pas Luftës së II-të Botërore u krijua nga shteti Agjencia Shqiptare e Filmave (1945), e cila më pas u shndërrua në Ndërmarrje Shtetërore Kinematografike Shqiptare (1947), kohë kur u bë shtetëzimi i plotë i rrjetit

të sallave, importit, dhe prodhimit. Xhirimi i filmave nis me kronika aktuale. Në maj të vitit 1948 u shfaq kinokronika e parë shqiptare. Në një vend me përqindje të lartë të analfabetizmit në vitet '40-'50, shteti i dha rëndësi shtimit të numrit të sallave dhe aparateve lëvizës, si dhe importit të filmave kryesisht nga vendet e Evropës Lindore, Franca e Italia.

Një etapë të re shënoi ngritja e së parës studio shqiptare të filmave, **Kinostudios "Shqipëria e Re"**, e cila u përrua më 10 korrik 1952. Fillimisht ajo pati si qëllim që, brenda një kohe të shkurtër, të krijonte kushtet e nevojshme për prodhimin e filmit kronikal e dokumentar brenda vendit. Në vitin 1957-1958 arriti të prodhonte filmin e parë artistik me metrazh të gjatë (Tana, regjisor Kristaq Dhamo), kurse në vitin 1959 xhirooi bashkëprodhimin shqiptaro-sovjetik Furtuna. Së bashku me fuqizimin e reparteve mbështetëse (dekoret, rrobaqepësia, kostumeria, rekuizita, ndriçimi, butaforia, etj.), në shkollat e larta jashtë vendit u përgatitën disa regjisorë, operatorë, piktorë skenografë, piktorë kostumesh, inxhinierë zëri etj, që mbajtën peshën kryesore të prodhimit kinematografik shqiptar në 20 vitet e para, si Kristaq Dhamo, Dhimitër Anagnosti, Viktor Gjika, Hysen Hakani, etj.

Filmi artistik shqiptar

Film i parë shqiptar konsiderohet të ketë qenë "Tana"¹, i autorit Kristaq Dhamo i xhiruar më 1958. Filmi trajton një temë nga jeta shoqërore e fshatit, ndërsa skenari mbështetet në novelën me të njëjtin titull të Fatmir Gjatës. Ngjarjet zhvillohen në vitet '50. Në qendër të filmit është Tana, një vajzë e zgjuar dhe me mendime të përparuara. Ajo dashuron Stefanin i cili banon në një fshat të varfër malor. Tanës i del përpara mentaliteti i vjetër i gjyshit të saj si dhe xhelozia e Lefterit. Është një lojë dashurie drejt përparimit. "Tana" njihet si filmi i parë shqiptar i cili përmbanë në skenë puthjeje në film.

Kurse filmat "Skënderbeu"² 1953 dhe "Furtuna" 1959, u xhiruan si bashkëprodhime me kinematografinë atëherë mike sovjetike. "Skënderbeu" edhe pse artistikisht një melodramë historike e pavlerë, ky

¹<http://www.youtube.com/ëatch?v=M-SxXb0QsëM>
Premiera ishte me 17 gusht 1958.

²http://www.youtube.com/ëatch?v=rJ_V6COFsC8

fili epik portretizon heroin kombëtar, që gjatë shekullit të 15 zbrapsi ushtrinë Turke duke i mbajtur larg kufijve shqiptar deri në vdekjen e tij. Realizimi i filmit u mor përsipër nga regjisori rus Sergei Yutkevich dhe në të luajnë disa aktorë shqiptar. Filmi përmban disa skena luftarake të mrekullueshme dhe fitoi Çmimin Ndërkombëtar në Festivalit e Kanës, në 1954.

Vitet '60 shënojnë prodhimin sistematik të filmit artistik në mesatarisht 1 film në vit, kryesisht me subjekte nga lufta kundër pushtuesve fashistë e nazistë (1939-44) dhe nga reformat e viteve të para pas luftës. Në këtë periudhë, regjisorët e rinj Dhimitër Anagnosti, Viktor Gjika, Gëzim Erebara, Piro Milkani, bënë filmat e tyre të parë.

Në vitet '70, me shkurtimin drastik të importit, si rezultat i politikës së izolimit të ndjekur nga shteti në fushën e kulturës, u shënua një rritje e ndjeshme e prodhimit, nga 5-6 filma artistikë në vit në fillim të periudhës, deri në 8-10, për të arritur në 14 në vitet '80, kurse në fushën e filmit dokumentar e kronikal realizoheshin mesatarisht 40-45 filma në vit. Në vitin 1974 u realizua filmi "Rrugë të bardha", i cili shënon të parin film artistik me ngjyra.

Filmi dokumentar shqiptar.

Lindi gradualisht që me kronikat e para, të cilat trajtonin thjesht ngjarjet e ditës dhe problemet e asaj kohe, deri në formimin e tij me të gjithë komponentët përbërës të një filmi të mirëfilltë dokumentar.

Dhimitër Pecani, një nga regjisorët e filmit dokumentar ne Televizionin shqiptar është shprehur se, "filmi dokumentar është historia, arti, kultura e një populli e shkruar në celuloid".

Dhe nuk janë të paktë realizuesit duke filluar që nga regjisorët, skenaristët dhe operatorët dhe deri tek montazhierët, formuluesit e muzikës, miksazhierët, të cilët kanë punuar me dëshirën e artistit që këtë histori, art, kulturë të popullit të tyre ta ndalin në celuloid dhe ta përjetësojnë në film.

Në fund të vitit 1962 u fut në prodhim e para atelie për xhirimin e filmave (rreth 1800 m² me mjediset përkatëse). "Gurët dekorativë" (1964) është dokumentari i parë me ngjyra i përpunuar në laboratorin e Kinostudios SHR.

Në vitet '70-'80 prodhimi i filmave dokumentarë u stabilizuan ërreth 20-40 në vit, dhe pati paratë të holla propagandistike, po edhe kulturore.

Filmat e parë për fëmijë

Regjisorja Xhanfize Keko, 1975 (ndër filmat e saj përmendim Beni ecën vetë³, 1975);

Kapedani (1972, kinokomedia e parë regj. F. Hoshafi e M. Fejzo); u bënë filma historikë e muzikorë; po zhanri më i pëlqyer mbeti filmi dramatik.

Krahas të tjerëve bënë filma një brez i ri regjisorësh, R. Ljarja, S. Kumbaro, I. Muçaj, K. Mitro, E. Mysliu. Nisi prodhimin e filmave artistikë edhe TV Shqiptar (Udha e shkronjave, 1978, regj. V. Prifti).

Në fund të periudhës dhe sidomos në vitet '80 filmi artistik shqiptar trajtoi më shumë aktualitetin si dhe ngjarje e personazhe para Luftës II Botërore. Në ekran u afirmuan regjisorë të tjerë me filma si

Ballë për ballë (1979, regj. K. Çashku e P. Milkani),

Dora e ngrohtë (1983, regj. K. Çashku), Agimet e stinës së madhe (1981, regj. A. Minga),

Kohë e largët (1983, regj. S. Pecani),

Tela për violinë (1987, regj. B. Kapexhiu), etj.

Filmi vizatimor shqiptar

Zana dhe Miri⁴ (1975, realizues Vlash Droboniku e T. Vaso).

Oëprejfilmittëparë, "Tana" (1958), derinë vitin 1995, në Shqipëri janë prodhuar 270 filma me metrazhtë gjatë, 700 dokumentarë dhe 150 filmatë animuar. Si pasojë e regjimit të ashpër komunist u bë e mundur të ruhej pothuajse gjithçka e prodhurnë Shqipëri që prej vitit 1952, filma artistikë, me metrazh të shkurtër, dokumentarë, të animuar dhe kronikat ëndryshme.

Arkivi i enderuan fotografii, postera, printime, skenarë, shënime, kolonazano redheshumë elementë të tjerë, të cilët zakonisht humbasin kur ndahen nëpërvend ndodhjet ëndryshme.

³<http://www.youtube.com/watch?v=x2Aqpp7Wyc0>

⁴http://www.youtube.com/watch?v=j_CH9LTeaxE

Me ndryshimin e sistemit shoqëror, në vitet '90, u bënë reformat e thella. Kinostudioja e dikurshme u ndanë disa studio, dhe filmat u prodhuan kryesisht nga shtepi filmike private (kryesisht regjisorët e kinostudiove të mëdha) në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (OKK), të ngritur në mesin e viteve '90, dhe me producentët e huaja.

Në vitin 1990 artistët formuan Shoqatën e Kinematografistëve Shqiptarë.

Arkivi Shtetëror i Filmit, dikur departament i Kinostudios "Shqipëria e Re", në vitet '90 u bë institucion më vetë. Është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmit.

HISTORIA FILMIT DHE TELEVISIONIT TË KOSOVËS

Në Kosovë Ahmet Zherka (1882-1967) nga Gjakova në fillim të vitit 1900 hap dyqanin e parë fotografik në vendlindje, pasi e mësoi zanatin në Budapest të Austro-Hungarisë. Megjithatë, vitet e para të zhvillimit të kinematografisë në Kosovë, nuk flasin edhe për ndonjë emër shqiptar që kishte zhvilluar ndonjë aktivitet të tillë në përgjithësi.

Sipas gazetës Male Novine (1912) që botohej në Serbi, projekcioni i parë i filmit në Kosovë është shfaqur në Pejë, në një hambar, në vitin 1911, nga kinematografi shëtitës, që kishte ardhur nga Cetina, mbas shpalljes së Mbretërisë së Malit të Zi. Në këtë kohë shfaqeshin kronikat filmike - (journal). Kronikat e para filmike të xhiruara në Kosovë, ishin bërë nga produksionet e huaja. Mund të përmenden kronikat, si:

Arnautët e zënë rob (1913) me xhirime të produksionit Pathe; Marrja e armatimit nga arnautët në Hanin e Dulës në rrugën për Prizren (6 mars 1913) kino Stinberg, Beograd; Vdekja e Mujës nga Lipjani (24 mars 1913) kino Stinberg, Beograd, etj.

Deri në përfundim të luftës së Parë Botërore, thuhet se forcat okupuese austro-hungareze, që kishin qenë në Kosovë, kanë pasur një kinema ushtarake që është quajtur FELDKINO, por nuk dihet se në cilin vend ka funksionuar ajo.

Në vitet 1935-37 kanë qenë të regjistruara 7 kinema: Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë dhe Pejë.

Kinematografia në Kosovë pas LNÇ

Pas vitit 1945 filmi i parë dokumentar për Kosovën i xhiruar në Kosovë ishte "Dritat e para" (1949), produksion i Avala Film, nga Beogradi, regjinë e të cilit e realizoi Zhivorad Mitrovic.

Në film paraqitet bashkëpunimi në mes shqiptarëve dhe serbëve për elektrifikimin e Kosovës. Ngjarja zhvillohet në regjionin e Istogut.

Regjisori i njëjtë, xhirooi edhe filmin e parë të metrazhit të gjatë me temë luftën, "Njësi i doktor M" (1955), ngjarja e të cilit zhvillohet në regjionin e Kosovës në kohën e Luftës ë Dytë Botërore. Për herë të parë, në njërin nga rolet paraqitet një shqiptar nga Kosova – Abdurrahman Shala, në rolin e Muratit.

Me të njëjtat motive, regjisori Zhivorad Mitrovic do të realizojë edhe filmat e tjerë si "Kapetan Lleshi" (1960) dhe "Obracun" (1962), në të cilët në rolet kryesore të shqiptarëve u paraqitën aktorë serbë, ndërsa për herë të parë muzikën e komponoi një kompozitor shqiptar, Rexho Mulliqi.

Shtëpia filmike "Slavija Film" nga Beogradi, në vitin 1959 realizoi filmin gjysmëdokumentar "Minatorët e Kosovës" (regjia dhe skenari Milos Stefanovic), në të cilin për herë të parë dhe për të vetmen herë, në një film në Kosovë, paraqitet aktori i njohur Bekim Fehmiu, në rolin e një minatori shqiptar i cili dashurohet në një femër serbe.

Me iniciativë të Abdurrahman Shalës, "Slavija Film", në maj të vitit 1961 hapi një zyre në Prishtinë, të cilën e udhëhoqte A.Shala, ndërsa në gusht të po atij viti, kjo zyre u shndërrua në "Studio Artistike", e cila shumë shpejt u mbyll. Para mbylljes kishte filluar xhirimi i një filmi dokumentar për ndërtimin e Termoelektranës në Obiliq "Ari i zi i Kosovës" (1963), regjinë e të cilit kishin filluar ta bëjnë Milos Stefanovic dhe Abdurrahman Shala, ndërsa e kishte përfunduar Sava Popovic.

Në dhjetor 1960 në Prishtinë u themelua Qendra Autonome Kulturore Propaganduese për regjionin e Kosovës e Metohisë (më vonë Qendra

Kulturore Propaganduese e KSA të Kosovës), detyra e së cilës ishte të zbatojë kinematizimin e vendit, të organizojë prodhimin e filmave, të bëjë dublifikimin në gjuhën shqipe, të aftësojë kuadrot për përdorimin e mjeteve teknike, të orngnizojë kinematë lëvizëse me kinoprojektorë 16 milimetërsh, dhe të distribuojë filmat. Në vitin 1966, kjo qendër realizoi filmin e parë dokumentar "Ekselencat" (prodhim i Kosmet film). Kjo qendër prodhoi edhe gjashtë filma të tjerë dokumentarë, në mesin e të cilëve edhe filmin "Skënderbeu" (1968) të regjisorit Zdravo Velimirovic, ndërsa po ashtu u realizua edhe filmi dokumentar "Një lindje" (1969) i Ekrem Kryeziut, që flet për Teatrin Krahinor të Prishtinës, e që ishte vepra e parë e një autori vendor nga Kosova.

Gjithashtu, kjo qendër në koproduksion me shtëpi të tjera filmike nga ish Jugosllavia realizoi edhe dy filma të metrazhit të gjatë, njëri nga ta "Uka i Bjeshkëve të Nemuna" (1968), sipas skenarit të Murteza Pezës dhe Abdurrahman Shalës, me regji të Miki Stamenovicit, dhe me muzikë të Rexho Mulliqit. Në rolet kryesore u paraqitën Ljuba Tadic (zëri i të cilit u sinkronizua në shqip nga Shaban Gashi) dhe Abdurrahman Shala.

Kjo qendër po ashtu dubloi në gjuhën shqipe edhe filmat "Kapetan Lleshi", "Kozara", "Beteja në Neretvë", etj. Veprimtaria e Qendrës u mbyll në vitin 1970, pasi një vit më herët (1969) u themelua "Kosova film", në krye të së cilës u emërua Abdurrahman Shala.

"Kosovafilmi" e filloi aktivitetin e vet me koproduksionet filmike. Në vitin 1970, u realizua filmi "Dashuria e parë", i cili film ishte një nga filmat më të shikuar në ish Jugosllavi, në rolin kryesor të të cilit u paraqit aktori Faruk Begolli, ndersa skenograf ishte Nuredin Loxha.

Filmi i parë i pavarur i metrazhit të gjatë "Si të vdiset", u realizua në vitin 1972, në regji të Miomir Stamenkovic, ndërsa në film paraqiten aktorët Mira Stupica, Faruk Begolli, Abdurrahman Shala, Istref Begolli, Xhevat Qorraj, etj.. Filmi flet për fatin e dy shokëve të luftës në Luftën e dytë botërore.

Deri në vitin 1974 Kosovafilmi angazhonte xhirues nga ish Jugosllavia, kurse me ardhjen e Azem Shkrelit (1938-1997) si drejtor, filluan gjërat të ndryshojnë. Kështu në vitin 1975 nga firma ARRIFLEX e Munihut arritën 2 kamera 35 mm Arriflex 2C dhe një 16mm Arri st 16mm, me komplet

pjesët dhe optika e nevojshme, që për atë kohe përdorshin në xhirime në ish-Jugosllavi.

Në këtë periudhë fillojnë të realizohen edhe veprat e para me kuadrat vendor të shkolluar jashtë vendit. Projektet e para filmike të ndërmarrjes së vetme për prodhim të artit filmik KOSOFAFILM i realizuan kineastët : Rudolf Sopi, Afrim Spahiu, Shaban Gashi, Murat Zeka , Shukri Kaçaniku dhe asistentë të kamerës Agron Nela e Kujtim Bejtullahu, me regjisorin e skenaristin Ekrem Kryeziu dhe Besim Sahatçiu.

Kështuë në vitin 1978, u realizua filmi dokumentar "117", që flet për bashkësinë e madhe familjare, në regji të Besim Sahatçiu, me xhirues Afrim Spahiun, të dy të diplomuar në Akademinë e Teatrit, filmit dhe televizionit në Zagreb. Filmi fitoi shpërblimin "Grand Prix" në Festivalin e filmit dokumentar në Beograd.

Me fillimin e prodhimit të pavarur u vunë themelet e prodhimtarisë filmike origjinale, me ngjyrimë të theksuara autoktone, që flisnin shqip dhe që paraqisnin kulturën e traditën tonë, por pati edhe dështime evidente në koproduktionet me producentë të tjerë, ku nuk iu kushtua kujdes aspak shkollimit të kuadrit teknik dhe artistik nga Kosova.

Filmat e prodhuar nga Kosovafilmi:

Dashuria e parë (1970, koproduktion); Rekuem për të nesërmen (1970, koproduktion); Koka ime e krisur (1971, koproduktion); Si të vdiset (1971); Hedhësit e bombave (1973, koproduktion); Sulmi i kuq (1974); Dervishi dhe vdekja (1974, koproduktion); Majat e Zelengorës (1976, koproduktion); Kur pranvera vonohet (1979); Era dhe lisi (1979, Besim Sahatçiu); Gjurmë të bardha (1980, Ekrem Kryeziu); Lepuri me pesë këmbë; Përroi vërshues; Njeriu prej dheut; Proka (1987, Isa Qosja); Pikniku; Rojet e mjegullës (1988, Isa Qosja), etj.

Filma dokumentarë

Kosovafilmi ka prodhuar edhe një numër të madh filmash dokumentarë nga të cilët ndër të dalluarit janë: "Brigadat kosovare"; "117" (1978, Besim Sahatçiu); "Bukë e kryp e Zemër"; "Tepricat" (1981, Ekrem Kryeziu); "Pik e Gur"; "Ngjyrat e dheut"; "Dita e Mërgimtarëve"; "Kur pranvera xhirohet" etj.

Si të vdiset (1971, Miomir Stamenkovic)

Filmi "Si të vdiset" ishte realizuar në vitin 1971. Premiera e tij u dha më 20 mars 1972. Filmi ishte realizim i Kosovafilmit, mirëpo në të pjesën e realizimit e bënë kineastë nga vendet e ish-Jugosllavisë, ndërsa në film luajnë aktorë shqiptarë, si: Abdurrahman Shala, Faruk Begolli, Istref Begolli, Shani Pallaska, Xhevat Qorraj, etj.

Era dhe Lisi (1978, Besim Sahatçiu)

Në vitin 1978 filloi realizimi i projektit filmik dhe serial TV, më i madhi deri atëherë në Kosovë "Era dhe Lisi", me regji të Besim Sahatçiu, që ishte produksion vendor. Në projekt kanë qenë të anagazhuar pos aktorëve kosovarë edhe një numër i konsiderueshëm i specialistëve të filmit dhe televizionit nga Televizioni i Prishtinës.

Premiera e "Era dhe Lisi" u dha më 6 korrik 1979.

Konsiderohet se projekti "Era dhe Lisi" ishte një sukses i madh artistik dhe organizativ i kinematografisë dhe televizionit kosovar . "Era dhe lisi" u shpërblye me disa çmime, si: "Arena e Artë" (për skenar dhe për rolin kryesor; Pulë, 1979); "Shpërblimi tradicional i kritikëve të filmit" (Sarajevë, 1979).

Kur pranvera vonohet (1979, Ekrem Kryeziu)

"Kur pranvera vonohet" ishte një seri televizive dhe film per kinema që trajton Luftën Nacionale Çlirimtare të partizanëve të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botrore. Seriali përbëhet nga pesë pjesë me kohëzgjatje prej 55 minutash. Në rolet kryesore prezendohen aktorët shqiptar si Hadi Shehu, Abdurrahman Shala, Melihate Ajeti etj. Regjin e ka bërë Ekrem Kryeziu në bazë të skenarit nga Azem shkrelu dhe librit-ditarit partizane te Fadil Hoxhes. Është prodhim i studios Kosovafilmi i vitit 1979.

Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK)

Qendra Kinematografike e Kosovës është institucion me atributet e autoritetit qendror për kinematografi. OKK ka për objektiv realizimin e politikave në fushën e kinematografisë që pasqyrojnë interesin publik. Qendra Kinematografike e Kosovës ka organet e saj drejtuese: Këshillin Drejtues dhe Drejtorin.

Këshilli Drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve.

Qendra Kinematografike e Kosovës në përputhje me buxhetin e miratuar shpall konkurs çdo vit. Konkursi hapet për këto kategori: film i metrazhit të gjatë, të shkurtër, film dokumentar, dhe film vizatimor/animuar.

Disa nga projektet e realizuara e të mbështetura nga QKK, mund të gjenden në linkun në vazhdim:

<http://www.qkk-rks.com/?id=1>